

KALJIMERE



La « *Kaljimera* » (parola greca, che significa semplicemente: « *Buon giorno* ») è, nella nostra tradizione popolare, una poesia epica, che, in semplice forma narrativa, racconta l' avvenimento festivo che si vuole celebrare. Si chiama così, perchè cori di giovani, forniti di vari strumenti musicali, usano cantarla di nottetempo, per le vie dell' abitato, quale augurio. E' una manifestazione di Fede e di Amore, che, sia nella gioia che nel dolore, erompe spontanea dai petti dei fedeli inneggianti alle grandezze di Cristo Redentore, della Vergine, dei suoi Santi, della Sua Chiesa. All' approssimarsi di una festività, si sentono questi Inni nelle case, nei vicinati, tra i muri austeri delle nostre Chiese bizantine, sotto gli sguardi amorosamente materni della nostra Panajia. Questi canti che pubblico, con la collaborazione attiva e preziosa del mio ottimo confratello E. Giordano, non sono che una minima parte della nostra ricca collezione, pazientemente raccolta nei vari paesi albanesi della Calabria e della Lucania. Le *Kaljimere* del Natale (la prima), di Pasqua, della Dormizione della Vergine e dell' Immacolata, appartengono alla raccolta lasciata dal Protopapàs Bernardo Bilotta, il quale, per mezzo della sua azione e dei suoi scritti numerosissimi, ha saputo infondere,

nei fedeli di Frascineto, tutto il suo immenso amore, per il rito bizantino e per le nostre tradizioni albanesi. Quelle della Passione, di Lazzaro e il Pianto della Vergine, furono da me raccolte dalla viva tradizione popolare. L'Inno a S. Atanasio proviene da S. Sofia d'Epiro e quello di S. Lucia da Mbusati, composto, quest'ultimo, dal Protopapas A. Argondizza, poeta di rara vivacità.

Avvertiamo i lettori che, per ragioni tipografiche, abbiamo dovuto tralasciare le « e muta », a discapito dell' ortografia, dove non erano strettamente richieste dalla retta pronunzia.

Quando voi, o amici Italo-Albanesi, canterete queste melodie, richiamate alla vostra memoria l'unica, vera, grande gloria dei nostri padri: la Fede profonda in Cristo Redentore, l'attaccamento indefettibile alla Chiesa di Roma!

P. Iosif Ferrari
dell' Eparchia di Lungro

Frascineto, 21 Novembre 1946.

KALJIMERA KRISHTLJINDJES

Mbi ca kasht e te nj' shpelj
Te nj' natez shum t' thell
Zoti Krisht u-lje për ne
Sot t' na jip nj' jet t' re.

Avgusti, Zot edhe i Judhes,
Dish t' dij, për frym t' vetëhes,
Sa gjind ish ç' nën ay kish,
Mndaj nga një i shkruar kish t' ish.

Pse kish gjindja t' shkruhej vet,
Edhe Shën-Mria e Shëjti Sep
Ven e shkruhen nd' Vithleem
Ku ata naten s' gjëjen vend.

Jasht Vithlemit nj' shpeljez gjëjen
Mbrënda hijtin sa t' fjëjen,
Po kur ish si ndaj mjesnat
Shën-Mria Ijeu Jisun pa-mbkat.

Nj' Ëngjell qelli u-kalar
E vate sgjoi dica deljar,
Ç' ishn e fjëjen dhenvet mban:
U lje Zoti Krisht i than !

Shpejt deljaret këmbet ngrëjen
E te shpelja më t' e gjëjen
Djaljit Shëjt e pjot butsi
Zëmrat qelljen mbë dhurti.

Si Djalj i vogel u-lje Inzot
Ç' me hare mbjon jeten sot,
Nj' yll ka delj hjemadhi diell
Ndëjtur Magrat pan ndër qieill.

Than: u-lje nj' Rregj i ri,
Na kem shohmi ay ku rri.
Nd' Jerusalim me yllin van,
Te rregj Irodh shkuan e pan.

Rodhi i ljak shpejt u-zëmrua,
Zëmra 'tij keq u-thartua,
Sa gjegj se nj' rregj i ri kish ljer,
Tha: ky s' ka t' rronj, po ka t' bjer !

Mbjoth kshtu zotrat e i pyjeti:
Zoti Krisht ku ljehej dijti:
Nd' Vithleem prej shpis Davidhi,
Virgjer ësht Mëma ktij Biri.

Shpejt ka Magrat Rodhi u pruar:
Ju thom gjith atë ç' ë shkruar,
Ecni prana ju e e çoni
E te ku rri ngin' e m' e thoni.

Magrat dualtin ka Irodhi,
Po Inzot më nëng i ljadhi,
Pse sa u-buthtua ylli ç' pan
Te Vithleemi njize ngan.

Yllthi mbi nj' shpelj qindroi,
Ku hijtin e Inzot i gzoi;
Mbi ca kasht pan Djaljn t' rin
Me Shën Sepen e Shën-Mrin.

Shëjtrat Magra gjith hare,
I puthjen duarxit me hje,
Shkarkojen smirn, Ijivan e ar
Ndër këmbejit Djaljit buljar.

Naten Magrat pra kur fjën
Ç' duaj Inzot ata kshtu xën,
Çë i mson t' mos t' priren më
Tek i ligu Irodhi ë.

Qeni Iroth sa nënga pa,
Se Magrat më s' u-pruartin pra,
Kam vras djaljet nën dy vjet,
Ashtu, tha, vdes edhe ky mbret !

Tek Irodhi kish kto tru,
Shëjtit Sep naten ia rru
Ëngjlli Zotit e i tha: ik
Tek ay dhe ç' ia thon Egjit.

Djalji, Sepa e Shën-Mria
Iktin natzen ka shpia
Mbjuatu ven te dheu i huaj
E rrin atje për shum muaj.

Prana ç' shkoi di u ca mot,
Ëngjlli nd' ènderr Seps i thot:
Djaljin mirr e shko nd' Judhe,
Se Rodhi s' rron më te ky dhe.

Sepa Djaljit tha: Bir, vemi,
Se tek dhe i huaj jemi,
Vemi mb' paq, vemi se vdiq
Rregji Iroth ç' na doj ljik.

Shën-Mria u-hip kaljuar
Me t' Birin Shëjt ndër duar,
E t' e rrur ndë Nazaret,
Ku Zoti Krisht ndënjet tridjet viet.

Dialj i Shëjt, ojeta jon,
Ndijena neve mbkatt t' on,
Për ktë u-ljeve Ti mbi dhe,
Sa t' na sillje nj' jet t' re.

Zonja Virgjér Shën-Mri,
Ndrrona neve e bën-na t' ri,
Ljut t' Ënzot t' na bekonj,
Për se Ti je mëma jon.

KALJIMERA LAZARIT

O mir mbrëma
Ksaj zotri
Çë ndë kto shpi
Ndodhet u thom !
 Gjegjni, një dit,
 Ç' bën Perëndia
 Te një katund
 Çë ia thon Vithania.

Ish nië njari
Çë thrritej Lazar
Ka Krishti i dashur
Me lkipisi.
 Dy motra kish
 Vetem, jo më,
 Me varfëri
 E pa mosgjë.

Lazari vdiq,
Se vdekja e mbjoth
Me Krishtin largu
Jeten i voth.
 E varrzuan
 Me shum vajtim
 Mir e pastruan
 E u vun mb' lkip.

Pstaj tek Inzot
U-nisn e van
Me ljot ndër sy
Muarn e than :
 O Zot, O Zot,
 Ndë kishe qën,
 Vdekur nëng kishem
 Vllaun t' ën !

Shini ato ljot
Pjeksni atà ljesh,
Mos kini dre
Se Lazari fjë.
 Moj çë na thua,
 O i math Inzot,
 Jan kater dit
 Ç' ay ësht nën bot.

Mua kinmi bes
Se u jam gjella,
U drita, Udha,
U vetem Zot.
 Inzot u nis
 Me Apostuljit,
 Gjindja e prit
 Me dishërim.

Po sa e rru
Te varri u qas,
Lazarin thirri
Me zë t' math.
 Me zë t' math
 Thrret e thot :
 Dilj jasht, o Lazar,
 Ngreu, ka ajo bot !

Lazari ngrëhet
Ka varri i zi,
E i jep laydi
T' Ljartit Zot.
 S' mund t' iu rrfienj
 Pra gjindjes thot
 Ç' heljm i math
 Ësht ajo bot.

Vetem ju thom
Se kush bën mir
Do t' gjënj mir
Te jetra jet.
E marmarosur
Gjindja qindroi,
Krishtin lavdoi
Si Perëndi.

Kët të vertet
Vangjelji e thot
Ra te kjo jet
Kur ecnej Inzot.
Njariu ç' rron
Me shëjten bes
Me gzym vdes
E me t' Ënzot.

KALJIMERA PASHKS

Ljeni shtratin, më mos fjëni,
Nxirni lüpjin e gzioni !
Trima e vasha, se na u-ngjall
Zoti Krisht hje-math pa zall.

Varrin çajti e fjuturoi
Si ka qielli çë gzoj,
Njota Pisa u-heljmua
Se gjith gjindja i u-ljshua.

E me 'të s'e shkon më keq
E t' ngjet ka Krishti e heljq.
Njota dita u-di e mir,
Vem' e puthmi fjalzen-mir,

Çë na msoj Zoti Krisht,
Me hare gjith vemi mb' qish !
Me hare gjith ljuemi sot
E këndoimi t' Ënzot.

Gzomi poka, pieq e t' iri,
Se e bukur dit na u-di :
Dit e dashur e e shërtuar,
Ndër gjith dit 't më e bekuar.

Me hare, vlezrit e mi,
Këndoimi bashk pjeq e t' ri :
Krishti qe e Krishti qoft,
Besa Krishtit mbi ne rroft !

Trima e vasha diljni e ljueni,
Pjeq e pjaka me ne gzioni !
Krishti u-ngjall si na kish thën,
Pisen shkelji e e vu nën.

Dritson vetëhea jon
Se na mban Krishti Inzon.
Dora Tij ë shum e mir
E na bën të fan-mir,

Aq ktu sa nd' jatret jet
Krah-hapt Krishti na pret
Ndër qiell pra ç' e nderomi,
Me t' mirat çë kem bëmi.

KALJIMERA JAVES-MADHE

Kujtomi sa për ne
Krishti duroi
Sa heljme edhe për 'Të
E Jëma shkoi,
Se sot ç' jan durimet
E Shën-Mris,
Mirrni-e vesh ju gjith
Zonjat e shpis,
Se na ju këndomi një
këndim arbrisht
Çë rrifi gjith durimet
T' Zotit Krisht.
Durimet t' Zotit Krisht
Qen si një shpat
Çë zëmren i shpuan
T' pa-mbkat.
Si Judha e rru e e puthi,
Judhit për ljeshi e zun
Nd' mest asaj udh
E ljithtin e m' e shtun.
Krishti, si qinq i but
Thoj me zëmer
Oj Tat ç' je ndër qiell
Ndlje kta t' nëmür.
Shplaka e pshtime
I dhan gjith nj' nat
Qinquit Perëndis
Të pa-mbkat.
Menatë sa u di
Ç' ish e Prëmtja-madhe
Te Pilati e sualtin
Me frym t' madhe.

Thrрисjen gjith sa ishen
Mirr-e e vëre mb' kriq
Ky mbreti ësht i dheut
Qesarit armik.
Pilati ljajti duart
E tha u nëng e ngas
Se ky ësht i tër-shëjt
E u s' munt t' e vras.
Po pstaj u trëmb e bëri
Si Judhit dishtin
Ndër duart atyrve e lja
E gjakun gjith i shprishtin.
Te një shtyl e ljithtin
E i ran me for
Sa gjaku Zotit Krisht
Vej si uj te kroi.
S' u fryjtin me kta gjak
Qent mixor
I pjekstin me ca gjëmba
Një kuror..
Nd' kriet ia ndëndtin fort
E me një hu
I shpoi ashtin e syut
E i hiri ndër tru.
Pilati kur e pa
Me at kuror
Me një cop t' kuqe
E nj' kalmer mb' dor :
Vreni njariu ! tha
E jasht ia buthto
Ju shini si e bët ?
Ju më ç' e doni ?

Thrriti qenria:

E duami mb' kriq
Sa t' ndënden gjith
Sa jan armiq.

Pilati u trëmb e tha :

Ecni me nëmet
Bëni-e si t' e doni
Ç' ju vrafshin gjëmbat !

Kceu si uljk Judhiu

Edhe m' u ndënd,
I vun nj' kriqe ngrah
Me dy drunjë t' rënd.

Krishti me kriqen ngrah

Vej tue rkuar
Judhit me shqeljbe e hunj
Tue malkuar.

Te malji kraniut

Pak t' gjall e sualn
I vun gozhda ndër këmb
Edhe ndër duar.

Tri or Krishtii rroj

I vijerr nd' at kriq
Ndljei gjith armiq
Par se t' vdis.

Dielli e hëna u-nzi

E dheu gjimoi,
Malji nd' mest u-nda
Si Krishti perëndoi.

Vate një ushtar

E zëmren i shpoi
Po gjaku Zotit Krisht
E dritsoi.

Josifi e Nikodhimi

Ka kriqja e nzuarn
Edhe t' vdekur s' jëmes
Ia vun ndër duar.

T' Birin t' vrar

Ndër gjunj e mbaj
Me ljet e me hidhi
Thoj kto vaj :

Bir, si t' vran

Mua ku m' ljan !

Si s' pattin lkipisi

Si s' t'ndihu mosnjari !

Vrej si t' nxijtin

Vrej si t' pshtijtin !

Ka t' erth ajo kuror

Kush t' e therti at dor !

Këto këmb t' ngrisquard

Cilja gozhd t'i lja t' shpuara !

Edhe zëmren t' shpuan

Me një shtiz t' farmakuar !

Pa tij, Bir, u si t' rronj

Këto thik s' munt t' i duronj !

Me tij, Bir, u dua t' shihem

Tek ky varr dua t' mbulihem !

Ngrëhi gjith me ljet

E me hidhi

E ksaj mbretresh gjith bëmi
shoqri.

Gjith t' mirat ndër Pashk

Ajo ju shkoft

Ju dhëft edhe Parrajsin

Ashtu qoft !

VAJTIMI SHËN-MËRIS

Popo, Bir, hjemath si diell
Çë t' e bënj u më t' rronj,
Se më s' të kam, o Bir, o Gjell!

Kët heljm u s' mund t' duronj,
Biri im çë më vdiqe
Si më i lligu mbi kët kriqe.

Mjera u si të t' vajtonj,
Biri im e zëmra ime
Çë pa tij u s' kam ç' bënj.

Heljm i math e me shërttime
Ësht e m' munden e m' vret
Mua mëmez aq t' shkret.

Bir, m' e more paqen t' ime,
Sa Ti ike, Bir, e m' lje,
Ndër aq heljme e shërtme.

Jeten t' ime ndër Judhit
Bir, u shoh e prëçmonj
Mjera u si kam t' rronj.

Dielli e hëna e gjith ky dhe
Njo, si t' qajen me hidhi,
Ndër t' zeza, çë s' kan hje.

Faqja diellit, Bir, u nxi,
Hëna u përlip e dheu
E reksi keq sa t' vrar t' vreu.

Qielli vet me mua t' qan
E m' jep fuqiz, o Bir,
Të ndljenj kuj s' të dish mir.

Bir hjemath e me hajdhi,
Si t' bënj u më të t' shoh
Sa t' m' qeshjen këta sy.

Sa keq, Bir, Bir, moj Bir,
Judhit muarn e t' vran
Sa dheu, dielli e hëna t' qan.

Gjith Parrajsi, Bir, popo,
Njo si vritet, e rkimi
Si m' ndihet si ka do.

Kjo gjind, o Bir, o trimi,
Kuj i bëre Ti aq mîr,
S' duan t' din se ishe imi.

Si t' e bëri, Bir, e m' lje
Kaq t' harruame mëm t' shkret,
Te kjo e rrem e e llig jet.

Bir, sa mir pat ky dhe
S' t' e kujton e njo si t' shan
E u si qen mbi tij e pe.

Me nj' shtiz t' farmakuar
I ljidhur e i vën mb' kriq
Vëra vëra qeve i shpuar.

Nëng t' pattin lkipisi,
Të pshtijtin, të xarristin
M' ljostin gjellen pa fuqi.

KALJIMERA SHËN-MËRIS GUSHTIT

Malli t' shih t' birin Zotin Krisht
Ljodhi e ljosë Shën-Mrin sa rënd i qlloj.
Apostuljit ç' ishen nd' jet shprisht
T' sheshrojen besen e t' birit ç' na shptoi
Mbjoth Shpirti Shëjt mban shtratit t' saj nderuar
Çë malli shëjt i t' Birit kish qlluar.

Gjith Ëngjiljt të stoljist me drit t' bukur
Me Zotin Krisht e Shpirtin Shëjt për krej,
Ahiera ljan qieljin ka gjith t' ljutur
T' vejen t' mirrjen Zonjen me 'ta t' vej,
Ku i Jati e prit me mall t' i uljej Zonj
Te krahu diatht e qiellit më t' i gzonj

Eja ! Ëngjiljt thojen Ti, o e dritsuar,
Ka qelli e kajeta çë nderove,
Eja me ne Ti, Nuse, më e bekuar,
Çë biljt e Adhamit ngrëjte edhe i ljartsove.
Ngreu Ti nuse e bukur e pjot hje,
E nga te qelli ljart, ku e pritur je.

E sgjuar Shën-Mria, e qelur si i ngit
Ka Shpirti Shëjt e i Biri dhaj si dual
Ka varri e me 'ta perpara u-ngjitet
Ngrah Ëngjëlvet çë shprishjen ljulje shual
E i këndojen këndime çë i kishen hje,
Se ajo ish dit me drit e me hare.

Kshtu Shën-Mria e qelur yll mbi yll,
Tue gzuar e e shkuar tue kënduar
E rrën hjemadhe tek më i lharti qiell,
Ku gjën diert e Parrajsit zgardulluar
E atje perpara t' Jatit çë e prit
Uljet ndë thron t' asaj ç' mburon me drit.

Dhaj si ahiera nga vit te dita sot
Gzon e bën kremte t' madhe qielli,
Gzogen Ëngjiljt e Shëjrat 'dhe Inzot,
Gzogen Ylqxit lhart e hëna e dielli;
Gzogen edhe l' Kershteret mbi kët dhe,
Se din ç' Shën-Mria ësht për ne.

Gzomi 'dhe na gjith sot e hare bëmi
T' Bekuares, t' Ljartes Virgjëresh,
T' Jatin, t' Birin e Shpirtin Shëjt nderomi
Dhaj si ka zakon katundi arbresh.
Nderomi sot Shën-Mrin, me Shëjrat bashk
Sot çë për jeten gjith ë njeter Pashk.

Kur i erth dita e thën
Lja Shën-Mria jeten t'ën
Te Parrajsi Inzot e shkoi
Me gjith kurmin fjuturoi.

KALJIMERA SHËN LUQISE

Dridhni vallen me hare
Ksaj Krishtit nuse t' re !
Çë kjo vashez çë hajdhiar,
Lambarisen nd' Alltar ?

Çë kjo l julje e dëlir
Çë mbjon zëmren me dëshir ?
Çë kjo zonjez drit-pjot,
Çë na qasi Inzot ?

Çë ky diell çë duall ndër re
E na mbjon shpirtin me hare ?
Këjo l julje rregjrie
Ësht e Virgjera Luqie !

O kjo vash sa bukuri
Ka ndë ball, ndër duar, ndër sy,
Tundu zëmer e këndo,
Dua-je mir sa mir t' do.

Zonj, t' l jipenj me shërttime:
Hir, zonj, te zëmra ime
Ndë hin Ti zonj pér mot
Hin me Tij edhe Inzot.

E kjo zëmer pjot mbëkat
Sbardhen më se bor mjesnat,
Po ç' thom u e lavur grua ?...
Ljë Luqin e fjas pér mua ?

E ndljem Ti vash me hje,
Fjas kshtu se zëmren m' ke,
Kam me mall zëmren pjot
Pér tij, Virgjer, 'dhe t' Enzot.

Po na duami të këndomi
Zëmi gjellen e ia thomi:
Ish një trim Syrakuz,
Një garoful kish pér buz.

Ish i dreqt si një kandil,
Ish trim e dukej yll,
Ish pjot buljari,
I kërkuar si kali.

Gra, burra, pjeq e t' ri
At trim hajen me sy,
Po trimit ata krye
Rrij e stisur nd' at Luqie.

Po Luqieja nd' at çer
Nëng ngrëjti syt nj' her.
Trim i u-nis një menat
Vate çoi zotin t' jat,

E i tha, me l jot ndër sy:
Ki pér mua l jipisi !
Zoti ym, e ki-me bes...
Pér Luqin t' ènde u vdes !

U jam me shum fuqi,
Pse s' bëhemë gjiri ?
U përgjeq pjaku buljar:
Trim i bukur e i hajdiar !

Si m' fjet ndë kët her,
Biri ym, m' bën ndër !
Munt t' e çonj u njeter bir,
Më trim e më t' mir ?

Hiri Shëjtja cë e thrirttin
Me hare t' dy e prittin.
I Jati i tha: Bilj, shpirti ym,
Njo i pari jets trim !

I bgat, me urtsi,
Çë me ne do t' bënj kushqi
« Zoti tat, ti qofsh i truar !
S' munt t' e marr, jam e martuar !

I jati e ruajti e vrëjti çeren,
Tha: ç' thua ? S' njeh ti heren !
Trim i u-ngre, si një petrit,
Tha: Kush ë ky dhëndrrri yt ?

Thuam nd' ësht ky i fanmir
Më i bgat e më i mir,
Nd' ësht i vogelj, trim o pjak
Dua t' e di, se ljosem gjak !

Zoti ym, nd' je buljar,
Ljem e mos ti më partar,
Mos hir me mua mbë mri,
Se mbi dhe s'ruanj njari.

Na, përpara atij c' dua,
jemi baljt, jemi buhua,
Dhëndrrri im kriarti qiellin
Bëri dhen, hënzen e diellin,

Dhëndrrri ym, me hir-pjot,
Ësht Krishti Inzot !
Oj Luqi, tha trimi i zi,
Ka t' erth kjo lavuri ?

Ti ng' e di se t' kershet
Vijen t' vrar si drangoljet ?
Via, me ljunje t' e kerkonj,
Rro ti vash, e u bën t' rronj !

Po ky Krisht ç' nëng e di,
Pse t' i bëri ata dy sy ?
Aq t' bukur, të shkeljqier,
Sa m' ljosjen mua t' mjer ?

Ndë je zonj me lkipisi,
Ëm-i mua ata dy sy !...
Qeshi Shëjtja me hare,
Do kta sy ? Menat i ke !

Duall trimi gjith i gzuar,
Tha: menat u jam i ndrruar !
Po s' e dij ç' kish nd' krye,
Shëjtja Virgjera Luqie;

Çë me ljotzit ndër sy
Mb' shpit, vetez, u mbuli.
U pergunj e t' tërez naten
Parkaljesi t' gjithve Taten:

Zoti Krisht, Parrajsi im,
Ti ljirojem ka ky trim !
U pataks edhe pa dre
Një taljur muar njenje.

Klau gjisht, holjq ata sy,
Sa i thyejtin si gershi,
E sa dielli m'u buthtoi
Syt trimit ia dergoi;

E t' tërez at dit,
Mbet e Virgjera pa drif.
Por sa naten i qlloj,
Vate një Ëngjell e m' e zgjoi :

Zonja nuse, i tha, si rri,
Kaq verbosurez, pa sy ?
Mos u trëmb, njo, më t' mir,
T'i dergon Krishti, fan-mir !

E Ti e Virgjera Luqie
Bëhu Shëjt, si ke ata krye,
Se ngë shkon, o nuse e re,
E t' marrmi e vjen me ne.

Po sa t' jetjeta e dheu,
T' parkaljesen i Kershteu
E t' jep Krishti fuqit
Gjindjes t' i shrosh syt.

Fjutoroi Ńgjilli ndér qiel,
Shéjtjes syt shkelqien si diell.
Shéjt e bukur e e fan-mir,
Syt e ri neve na prir !
Ki pér ne Ti lkipisi
E na ruaj me t' éndet sy,
Syt e kurmit na beko,
Syt e shpirtit zrukuro;

Sa t' rrimi na mbi dhe
Bén t' i kemi Krishtit hje.
Tek e prasmja jona dit,
Dilj pérpara e na prit,
Të gzomi mot pér mot
Tek Parrajsi t' Ńnzot,
T' Ńnzot e Shén-Mrin
E Tij Virgjeren Luqin.

KALJIMERA SHÉN-MÉRIS PA-FTES

(9 Shén-Ndreut)

Me drit më t' bukur dielli
Sot zë e shkelqen mbi ne,
Se gas na siell ka qelli,
T' e gzomi na mbi dhe.
Nëng shih më mir njariu
Ka do i venej syu,
Po shih t' keq durime
Perzier me malkime.

I ljigu diall tru-holl
Thoj: qela dhun me nj' moll,
Ftesa ç' u bë s' paguhet
Maj më vertet si duhet.

I ljigu dish t' harrohej
Se gruaja kish t' dergohej
Ç' kish taksur Inzot,
Ç' mban fjaljen ç' thot.

Ay s' doj t' e kish bes
Se nj' grua shum e ljart
Piksur pa fare ftes
Kryet i bënej baljt:

Shén-Mria éshjt kjo grua
Ç' sot na u-buthtua
Si ljljez e bekuar
Ka nj' dhe gjith tē thartuar.

Pér këtez grua qelli,
Ç' na merr syt si dielli
Më se Ńgjiljet me drit
Dhaj si Asaj i ngit.
U-piks sa tē na gzonej
Ka pjaka Ann, pa-ftes
Zonja Virgjëresh
Me t' Birin t' na ljjonej

Inzot e bëri t' mir
Sa s' kish më si t' e bënej
T' e shih t' shéjt e fan-mir
Te ndera 'Tij t' e ngrënej.

Kjo éshjt gruaja e mir
E taksur tē na gzonej,
Ka pisa tē na nxir,
Parrajsin t' na zbuljonej.

Gzohu poka ti jet
Ljuaj, o Ev e shkret !
Mbajohu bot me hare,
Sot u-piks nj' Ev e re !

Ruaj-na, o Shén-Mri,
Mbaj mbi ne ata sy,
T' shurbejem mbi dhe t' Ńnzot
T' e gzojem ndér quell nga mot !

KALJIMERA SHËN ATHANASIT

Dita jote gas na siell,
Shën 'Thanas ç' rri ndër quell,
Parkaljes Krishtin për ne
Se ndihmja jon Ti vetem je.

Ti nderove Aleksandrin
Ti shpëtöve Orthodhoksin
Qisha t' mban si shtyll t' par
Çë dritsove jeten mbar.

Ari i ljak egjren kjsh shprishur
Edhe Besen t' on kish grisur,
Ture thën se i Biri Shëjt
Me t'Jatin gjith një s' esht.

Po Ti dolle yll ndër quell
E shkeljqeve më se diell
E na mbson se një Inzot
Ndër Tri Veta Besa thot.

Se t' e ruajmi Besen t' ende
Ndëj-na doren tek Ti gjënde,
Ashtu nd' emrit t' end nga mot,
Lavdi past ka na Inzot.

Emri yt u-shprish mbi dhe
Me at Bes si Ti e the;
Ari pjasi! Po kush shkoi,
Kush si Ti heljme duroi?

Eresin t' madhe t' par,
Ti e shkulje dhaj si bar
Ti, si thik, me shkrime e preve,
Shiu i Shëjtris Ti qeve.

E verteta të peljceu
Më se t' mirat ç' jep dheu
E Ti vure gjuh si shpat
E perandor ljuftcve shtat.

Qishen Shëjt ç' Ti nderon,
Si mëm t' mir Ti na e buthton
Ndihna Ti me 'Të t' jemi,
Kshtu t' Inzoti t' i peljqemi.

KËNDIM I SHËN-MËRIS

Zonja sgjedhur Ti je Virgjëresh
Je Nuse, Jëma edhe e Bilja t' Inzoti
Qielli e dheu Te këndon Perëndesh
Hir-pjot e hjemadhe je Ti.

*E bukur je më se dielli
Si yll Ti shkelqen te qielli
Edhe ylqizit më t' shkelqier
Nëng jan t' bukur si je Ti.*

Je më e bardh se drita menatës
Je më e bukur se l juljet e jets,
Ndëse vrejem ylqizit e nats
Nëng jan ylqiz t' bukur si Ti.
E bukur.....

Ata sy më t' bukur se drita
Prir mbi ne çë T' thresmi me bes
Tij të truhemi, Virgjer, nga dita,
Shpresen t' on kemi vetem tek Ty.
E bukur.....

Ato buz me ç' puthen t' Ënzot
Vër mb'gas edhe ndihna ndër heljmet
Se ndër heljmet na shëomi t' têr jeten
Paqen na gjëmi vetem tek Ty.
E bukur.....
